

Njoftim për përqendrim ndërmjet V.A.G. pejment solushens a.s. Çeki dhe Grupi Inelo S.A. Poloni

(lënda nr. 08-149/2022)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 04.11.2022, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim i përqendrimit që i referohet fitimit të kontrollit të pavarur nga **V.A.G. pejment solushens a.s.** (W.A.G. payment solutions, a.s.), me seli në Pragë 4, Na Vitezne plani, 1719/4, Pragë 140 00, Republika e Çekisë mbi shoqërinë **Grupa Inelo S.A.** (Grupa Inelo S.A.), me seli në Bielsko-Biala, në adresën: rr. Karpacka 24/B13, 43-300 Bielsko-Biala, Poloni.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:

V.A.G. pejment solushens a.s. është aktive në sektorët e mëposhtëm: tregti me pakicë dhe shumicë e karburanteve; shërbime për zgjidhje pagese përmes kartave të karburantit; shërbimet e parkimit të kamionëve dhe larjes së kamionëve; Zgjidhje TI për sektorin e transportit rrugor komercial; zgjidhje të navigimit; shërbimet e veglave; shërbimet tatimore. Është pjesë e grupit Eurovag, i cili është aktiv në rreth 30 vende të botës (kryesisht në Evropë).

Grupi Eurovag nuk ka shoqëri të regjistruara në Maqedoninë e Veriut.

Grupi Inelo S.A. është një shoqëri që ofron shërbime këshillimi dhe financimi për shoqëritë e saj. Grupi Inelo kontrollon grupin e shoqërive aktive të cilat janë aktive në zgjidhjet e TI-së për sektorin e transportit rrugor komercial dhe në ofrimin e një sërë zgjidhjesh të TI-së për transportin rrugor komercial, duke përfshirë harduerin dhe softuerin.

Grupi Inelo S.A. ka një shoqëri të regjistruar në Maqedoninë e Veriut, Shoqërinë për teknologji informatike dhe shërbime konsulente CVS MOBILE MK SHPKNJP Shkup, dhe ka gjeneruar të ardhura duke ofruar zgjidhje TI për transportin rrugor komercial.

Parashtruesi i njoftimit konsideron se si treg relevant, për qëllime të vlerësimit të përqendrimit, mund të përcaktohet ***tregu për ofrimin e zgjidhjeve të TI-së (shërbime, softuer dhe harduer) për sektorin e transportit rrugor komercial.***

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

08.11. 2022

Shkup